

Mesazhi i Mitropolitit të Apolonisë dhe Fierit Hirësisë të tij Nikolla - Pashkë 2020



Krishti u Ngjall!

Ditët e qëndrimit tonë në karantinë, na kanë bërë të vlerësojmë dhuratat që na ka dhënë Perëndia, si:

Dhuratën e lirisë, vetëm ideja që nuk je i lirë, të sjell një tronditje dhe melankoli shpirtërore.

Dhuratën e shoqërisë, të marrëdhënieve dhe të komunikimit me të tjerët. «Ferri, – shprehen disa teologë, s'është gjë tjetër veç pamundësia për të parë dhe komunikuar me njëri-tjetrin».

Dhuratën e jetës adhuruese të Kishës. Të mos kesh mundësinë të jetosh jetën e misterit të Kishës, është baraz me një të etur që shikon burimin, por nuk mund t'a shijoj dot ujin e tij.

Së fundmi, dhuratën e jetës, pasi çdo moment rrezikohemi të prekemi nga ky virus dhe mund të humbasim jetën tonë, apo njerëzit tanë të dashur. Këtë ndjesi të

dhimbshme po e përjetojnë tashmë me mijëra njerëz që kanë humbur të dashurit e tyre nga kjo pandemi.

Por, pikërisht, në këto momente të vështira dhe të dhimbshme vjen Gëzimi dhe Shpresa e Ngjalljes.

Gëzim dhe Shpresë që ka mundësi t'a munda këtë hidhërim.

Gëzim dhe Shpresë se Zoti e munda vdekjen.

Gëzim dhe Shpresë se ata që besojnë në Zotin e Ngjallur nuk humbasin, nuk munden, por fitojnë duke kaluar nga vdekja në jetën e përjetshme, aty ku nuk ekziston ligësia e të ligut, pushteti i të fortit dhe as arroganca e të pabesit, por vetëm mirësia, drejtësia dhe dashuria.

Kemi sigurinë se Jisu Krishti është Zoti i jetës dhe i vdekjes!

Me bekimet e Perëndisë!

Mitropoliti i Apolonisë dhe Fierit

+ Nikolla